VENDIM
Nr.1070, datë 23.7.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE "PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE", NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIMIT TË SAGEM SECURITE DHE FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha